



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok. 201601697/5**

**Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016**

**Lënda :** *Rekomandim për dhënien e dokumentit të kërkuar nga shtetasi G.O.*

**Drejtuar :** **Shefit të Komisarariatit të Policisë nr. 4**  
**Z. Alket SHATRO**

**Tiranë**

***I nderuar zoti Shatro,***

Sikurse ju kemi vënë në dijeni me shkresën nr. K2/G19-2 Prot., datë 01.09.2016, në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi G.O., i cili banon në adresën: Rr. "A. Kasëmi" nr. 15, Tiranë. Ankuesi shkruan se, që në vitin 1994 ka ndërtuar një kioskë në truallin e tij me leje provizore të organeve të pushtetit vendor. Në vitin 2006, këtë kioskë ia ka dhënë me qera shtetasit Y.N.. Në fillim të muajit Gusht 2016, ankuesi i ka kërkuar qiramarrësit Y.N. ndërprerjen e kontratës dhe kthimin e kiokës. Shtetasi Y.N. jo vetëm që nuk ia ka kthyer kioskën por ka bërë kallëzim ndaj tij në Komisariatin e Policisë nr. 4 Tiranë.

Në datën 01.08.2016, rreth orës 19:00, ankuesit i kanë shkuar në banesë disa punonjës policie dhe i kanë komunikuar se do të shoqërohej në komisarjat sepse ka prishur qetësinë publike dhe ka kërcënuar shtetasin Y.N.. Pas komunikimit punonjësit e policisë e kanë shoqëruar atë në Komisarjatit të Policisë nr. 4 Tiranë. Sipas tij, ai është mbajtur 12 orë në një dhomë shoqërimi dhe i mbyllur me hekura. Gjithashtu ai pretendon se është marrë në pyetje nga punonjësit e policisë pas pesë orësh nga koha e shoqërimit dhe megjithëse u pyet nuk është lënë i lirë menjëherë pas pyetjes së tij. Ndërkohë ankuesi pretendon se, pasi është lënë i lirë ka kërkuar ti jepet një dokument nga komisarjati për arsyet ligjore të shoqërimit dhe kohën e qëndrimit në gjëndje shoqërimi, por ajo nuk i jepet.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, me shkresën e cituar më sipër ju kërkuam shpjegime rreth pretendimeve të ankuesit. Ju me shkresën nr. 4439/1 Prot., datë 09.09.2016, na informuat se në Komisarjatit të Policisë nr. 4 Tiranë, në datën 01.08.2016, në orën 21:00, është shoqëruar shtetasi G.O.. Shoqërimi i tij është bërë nga forcat e posaçme "Shqiponja" dhe motivacioni i shoqërimit të tij është për "Prishje të rendit dhe të qetësisë publike". Gjithashtu na informuat se është bërë intervistimi i shtetasit të cituar më sipër, i cili ka shpjeguar se ka bërë debat me shtetasin Y.N. për çështje pronësie, debati ka qënë me ton të lartë. Mbas marrjes në intervistë shtetasi G.O., në orën 00:05 të datës 02.08.2016 është lënë i lirë të largohet nga ambientet e Komisarjatit të Policisë nr. 4 Tiranë.

Nga përgjigjia juaj, të cilën e përshkruam më sipër, konstatojmë se nuk na keni dërguar informacion lidhur me pretendimin e ankuesit se, nga organi juaj nuk i jepet një dokument zyrtar për arsyet ligjore të shoqërimit dhe kohën e qëndrimit në gjëndje shoqërimi në komisariat megjithëse e ka kërkuar atë disa herë.

Ju sjellim në vëmendje përmbajtjen e pikës 5 të nenit 109 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", ku parashikohet se:

*"Punonjësi i policisë, dokumenton në procesverbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar."*

Ndërkohë konstatojmë se mosdhënia e dokumentit të kërkuar nga ankuesi përbën shkelje të të drejtës kushtetuese të informimit të garantuar nga neni 23 i Kushtetutës dhe ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Bazuar në këto akte normative, gjykojmë se ankesa dhe pretendimi i ankuesit lidhur me mosdhënien e këtij dokumenti është i bazuar në ligj. Ndërsa qëndrimi i mbajtur nga organi juaj në këtë rast çënon të drejtën kushtetuese e ligjore për informim të ankuesit.

Ndodhur në këto rrethana, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës, ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike" dhe në nenin 21/b të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku parashikohet se: "Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive";

### **REKOMANDOJMË:**

1. Zbatimin me korrektesë të akteve normative të cituara më sipër, duke i dhënë shtetasit G.O. kopje të procesverbalit të mbajtur nga punonjësi i policisë lidhur me shoqërimin e tij në organin e policisë në datën dhe orët respektive, si dhe arsyet ligjore të shoqërimit, ose dhënien e një dokumenti tjetër nëpërmjet të cilit të konfirmohet ky fakt.

2. Përgjithësimin e këtij rasti në efektivin e organit tuaj me qëllim që raste të tilla të shkeljes së të drejtës së informimit të shtetasve të mos përsëritem më në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve konform nenit 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**